



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 116

Tiranë – E martë, 6 gusht 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 48/2019 datë 18.7.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”..... 8719
Dekret i Presidentit nr. 11249, datë 5.8.2019	Për shpallje ligji..... 8725
Ligj nr. 54/2019 datë 18.7.2019	Për nismën ligjvënese të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë.... 8725
Dekret i Presidentit nr. 11250, datë 5.8.2019	Për shpallje ligji..... 8730
Dekret i Presidentit nr. 11246, datë 31.7.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 8730
Dekret i Presidentit nr. 11247, datë 31.7.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8731
Udhëzim i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë nr. 17, datë 30.7.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”..... 8731
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 556, datë 29.7.2019	Për mënyrën e vendosjes në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën ndaj të cilit është marrë masë mbrojtjeje..... 8755
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 435, datë 25.7.2019	Për masat e mëtejshme urgjente në vitet 2019–2021, për rezervat e pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (në zona gjeografike 17 dhe 18) [Rekomandimi GFCM/42/2018/8]..... 8757
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 442, datë 29.7.2019	Për miratimin e planit të menaxhimit të peshkimit, liqeni Ulëz–Shkopet 2019–2029..... 8758

Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasit Kujtim Belegu.....	8758
Korrigjim gabimi material në udhëzimin nr. 499, datë 2.7.2019, “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike” botuar në Fletoren Zyrtare nr. 109, datë 26.7.2019.....	8758



LIGJ
Nr. 48/2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR STATUSIN
E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 8, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Papajtueshmëria ambientale

1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë.

2. Këshillat, gjatë emërimit, transferimit, apo ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, efienca e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë.

3. Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme:

a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni;

b) nëse gjyqtari që kërkon të caktohet në një gjykatë administrative të shkallës së parë, ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një gjyqtar tjetër, që ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe anasjelltas;

c) nëse gjyqtari që kërkon të caktohet në seksionin civil të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një gjyqtar tjetër, që ushtron funksionin në seksionin civil të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën e shkallës së parë, si dhe anasjelltas;

ç) nëse magjistrati që kërkon të caktohet në seksionin penal të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në prokurorinë në juridiksion të kësaj gjykate, ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, me një magjistrat tjetër që ushtron funksionin në prokurorinë pranë gjykatës së apelit ose në seksionin penal të gjykatës së apelit, që ka nën juridiksion gjykatën dhe prokurorinë e shkallës së parë, si dhe anasjelltas.

4. Magjistrati nuk mund të caktohet në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme nëse një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1, të këtij neni, ushtron funksionin në këto struktura.

5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për emërim, transferim, apo ngritje në detyrë, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni.

6. Nëse papajtueshmëria ambientale lind gjatë ushtrimit të funksionit, apo është krijuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, rregullat e parashikuara në këtë nen nuk zbatohen. Në këtë rast, me pëlqimin e tij, magjistrati mund të caktohet në një seksion tjetër.

7. Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurat e zbatimit të këtij neni.”.

Neni 2

Në nenin 9, pikat 7 dhe 8, ndryshohen si më poshtë:



“7. Magjistrati, pa cenuar afatet e përcaktuara dhe ushtrimin në mënyrë eficiente të funksioneve, mund të marrë pjesë në veprimtari të papaguara jashtë funksionit, pa miratimin e Këshillit, vetëm në rastet kur:

a) vepron si përfaqësues i gjyqësorit ose prokurorisë;

b) merr pjesë në aktivitete për çështje të lidhura me sistemin gjyqësor ose të prokurorisë dhe bën deklaratat publike të përgjithshme në kuadër të pjesëmarrjes në këto aktivitete;

c) merr pjesë në diskutime për çështje të ligjit.

8. Magjistrati raporton, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, në Këshill, për veprimtaritë e papaguara jashtë funksionit, ku ka qenë i përfshirë në vitin paraardhës.”.

Neni 3

Në nenin 23, pika 10, ndryshohet si më poshtë:

“10. Magjistrati nuk mund të kryejë mungesa në detyrë, me përjashtim të rasteve të justifikuara, të parashikuara në legjislacionin në fuqi. Kryetari, me vendim të arsyetuar me shkrim, zbret nga periudha e pushimit vjetor të të njëjtit vit ditët e mungesës së pajustificuar. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e kryetarit, në Këshill brenda 7 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Nëse zbritja nuk mund të realizohet, kryetari njofton Këshillin, i cili merr masa që magjistrati të mos paguhet për ditët që ka munguar.”.

Neni 4

Në nenin 26, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, shkronja “a”, ndryshohet si më poshtë:

“a) arsye të përkohshme personale ose familjare për një kohëzgjatje të kufizuar deri në dy vjet;”.

2. Pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) kur angazhohet për shkak të funksionit të magjistratit edhe në detyra të tjera, kur parashikohet nga legjislacioni në fuqi.”.

2. Në pikën 3, shkronja “a”, ndryshohet si më poshtë:

“a) në rastet e parashikuara në pikën 1, shkronja “a”, të këtij neni, magjistrati kërkon ulje të ngarkesës në punë, nëse kjo nuk cenon interesat thelbësorë të funksionit, afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikente të funksioneve në gjykatën ose prokurorinë përkatëse;”.

3. Në pikën 4, shkronja “b”, ndryshohet si më poshtë:

“b) rregulla për uljen e pagës dhe të përfitimeve të tjera, kur magjistrati ndodhet në kushtet e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit;”.

Neni 5

Në nenin 41, pika 2, në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët: “brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit”.

Neni 6

Në nenin 43, pika 7, nënndarja “ii”, “fjalët: ‘nga Këshilli i Lartë Gjyqësor’ zëvendësohen me fjalët: ‘nga këshillat’”.

Neni 7

Në nenin 44, pika 4, në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët: “brenda 5 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit”.

Neni 8

Në nenin 48, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas fjalëve: “Prokurorinë e Përgjithshme”, shtohen fjalët: “Prokurorinë e Posaçme”.

2. Në pikën 9, shkronja “a”, nënndarja “ii”, fjalët: “nga Këshilli i Lartë Gjyqësor” zëvendësohen me fjalët: “nga këshillat”.

Neni 9

Në nenin 64, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shkronja “c”, ndryshohet si më poshtë:

“c) mbush moshën 67 vjeç;

2. Pika 4, ndryshohet si më poshtë:



“4. Mandati i Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme mbaron në fundin e muajit në të cilin mbush moshën 67 vjeç, pavarësisht viteve që ai ka qenë në detyrë në këtë pozicion.”.

3. Pika 5, ndryshohet si më poshtë:

“5. Statusi i magjistratit mbaron në fund të muajit në të cilin magjistrati mbush moshën 67 vjeç. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës.”.

Neni 10

Në neni 70, pika 3, fjalia e dytë, ndryshohet si më poshtë:

“Këshillat miratojnë rregulla të detajuara për vlerësimin e magjistratëve në skemën e delegimit ose të komanduar.”.

Neni 11

Në nenin 78, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“3. Vlerësimi i përgjithshëm “shumë mirë” jepet vetëm në ato raste kur magjistrati vlerësohet “shumë mirë” për tri kritere dhe “mirë” për njërin prej tyre. Në çdo rast, kriteret “aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit” dhe “etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit dhe të prokurorisë” duhet të jenë vlerësuar “shumë mirë.”.

Neni 12

Në nenin 85, pika 1, në fjalinë e dytë, fjala: “pasardhës”, zëvendësohet me fjalën: “përkatës”.

Neni 13

Në nenin 91, pika 4, pas fjalës: “vendim”, shtohet fjala: “jopërfundimtar”.

Neni 14

Në nenin 95 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 5, fjalët: “ose me vlerësim më të ulët” hiqen.

2. Pika 7, ndryshohet si më poshtë:

“7. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e vlerësimit të Këshillit, në gjykatën kompetente, brenda 15-ditëve nga data e

njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale.”.

Neni 15

Në nenin 97, pika 6, ndryshohet si më poshtë:

“6. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin e Këshillit për vlerësim, në gjykatën kompetente, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, vetëm për shkelje të rënda procedurale.”.

Neni 16

Neni 101, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 101

Shkeljet disiplinore

1. Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur:

a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbyllje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë;

b) gjatë ushtrimit të funksionit nuk i referohet ligjit ose fakteve, me dashje ose për shkak të pakujdesisë së rëndë, ose kur ka paaftësi të dukshme profesionale.

2. Kur përcaktohet nëse veprimi, mosveprimi apo sjellja e magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merret parasysh:

a) shkalla e pakujdesisë;

b) shpeshësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes;

c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem;

ç) dëmtimi, mundësia e shkakut të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe

d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.”.



Neni 17

Neni 102, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 102

**Shkeljet disiplinore në lidhje me
ushtrimin e funksionit**

1. Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magistratit, si më poshtë:

a) mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit, nëse magistrati ka dijeni ose duhet të kishte dijeni të rrethanave të tilla;

b) paraqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, nëse ky veprim:

i) nuk bazohet në shkaqe të parashikuara në ligj;

ii) bëhet me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose synon shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magistrat tjetër;

iii) nuk kryhet menjëherë pasi merr dijeni për shkakun;

c) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e funksionit të një magistrati tjetër;

ç) mospërmbushja e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;

d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;

dh) veprimi, mosveprimi ose sjellja e magistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;

e) angazhimi i personave të jashtëm në kryerjen e detyrave që me ligj i takojnë magistratit ose delegimi i detyrave apo veprimtarive që lidhen me ushtrimin e funksionit të magistratit;

ë) vonesa e përsëritur dhe e pajustificuar për fillimin e seancës gjyqësore ose zvarritje e hetimeve;

f) mungesa e pajustificuar në detyrë, sipas parashikimeve të këtij ligji, për më shumë se 3 ditë pune në vit;

g) shkelja e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorisë;

gj) moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga Këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magistratit;

h) mospërmbushja pa shkaqe të pajustificuara e detyrimit për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara me ligj;

i) mosnjohimi nga magistrati i kryetarit dhe Këshillit, si dhe autoriteteve kompetente, sipas ligjit, për ndërhyrjet ose format e tjera të ndikimit nga magistratët e tjerë, avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë ose subjektet e tjera;

j) shkelja e rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, të parashikuara në legjislacionin në fuqi, për të cilat merr dijeni për shkak të funksionit të magistratit ose që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces ose i përfunduar;

k) pengimi i Këshillit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo çdo organi tjetër publik në kryerjen e funksioneve të tij, sipas ligjit;

l) mospërmbushja nga ana e kryetarit e detyrimeve të përcaktuara në ligj, në veçanti detyrat e lidhura me sistemin e menaxhimit të çështjeve;

ll) bërja publike e mendimeve që janë dhënë nga vetë magistrati ose magistratët e tjerë gjatë procesit që nuk kanë marrë ende formën e një akti të disponueshëm për publikun;

m) bërja e deklaratave publike në media për çështjet, me përjashtim të komunikimeve për shtyp të magistratit brenda kufijve të detyrës së tij;

n) mosnjohimi i Këshillit për ekzistencën e shkaqeve të mbarimit të mandatit;

nj) mosnjohimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga ana e kryetarit, lidhur me fakte në dijeni të tyre, që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të magistratit;

o) mosnjohimi i Këshillit, nga ana e kryetarit, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë, kufizimeve të funksionit, dhe për çështje, për të cilat ligji parashikon mbarimin e mandatit të magistratit;



p) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 101, të këtij ligji, shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit si magjistrat janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjellja e magjistratit, si më poshtë:

a) mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë;

b) parashtrimi i shtrembëruar i fakteve dhe rrethanave në mënyrë të dukshme në aktet e nxjerra;

c) nxjerrja e akteve të paarsyetuara ose që përmbajnë, në pjesën arsyetuese, vetëm përfundime mbi ligjin e zbatueshëm pa parashtruar rrethanat e faktit, në të gjitha ato raste kur ligji kërkon nxjerrjen e aktit në formën e arsyetuar;

ç) nxjerrja e akteve, ku pjesa përshkruese - arsyetuese parashtron rrethana që janë haptazi në kundërshtim me pjesën urdhëruese ose që nuk kanë lidhje me të;

d) marrja e vendimeve qëllimisht të paarsyetuara, si rezultat i një interesi personal ose keqdashjes;

dh) shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore.”.

Neni 18

Neni 103, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 103

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit

Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratit, si më poshtë:

a) shkelja e rregullave të papajtueshmërisë me funksionin e magjistratit ose të kufizimeve për shkak të funksionit, sipas parashikimeve të bëra në nenet 6 dhe 7, të këtij ligji;

b) përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët;

c) ushtrimi i veprimtarive, me pagesë, jashtë funksionit, pa miratimin paraprak të Këshillit;

ç) shoqërimi me persona që janë nën ndjekje penale, janë subjekt të një procedimit penal ose me persona të dënuar dhe të parehabilituar, kur nuk kanë lidhje të ngushta gjaku ose ligjore me magjistratin ose vendosja e marrëdhënieve të papërshtatshme të biznesit me këta persona;

d) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të pozicionit të magjistratit, edhe në rastin kur formalizohen me një veprim juridik;

dh) raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës.

Neni 19

Neni 104, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 104

Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepe penale

1. Shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale janë veprimet, mosveprimet ose sjelljet, për të cilat magjistrati është dënues me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundërvajtjeje penale dhe që, sipas natyrës së tyre, diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit ose dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, bazuar në faktet dhe rrethanat e pranuar nga gjykata.

2. Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një kundërvajtjeje penale janë edhe veprime, mosveprime ose sjelljet, sipas pikës 1, të këtij neni, pavarësisht se vepra penale është shuar, ndjekja penale nuk mund të fillojë ose nuk mund të vazhdojë, ose magjistrati është rehabilituar, ose ka përfituar nga falja apo amnistia.

3. Masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet vetëm nëse dënimi me vendim të formës së prerë është dhënë për kryerjen e një krimi. Në këtë rast,



gjatë procedurës disiplinore, parashikimet e këtij ligji zbatohen për atë që është e nevojshme.”.

Neni 20

Në nenin 126, pika 5, fjala: “procedimit”, zëvendësohet me fjalën: “parashkrimit”.

Neni 21

Në nenin 141, bëhet ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet, si më poshtë:

“1. Gjatë procedurës disiplinore, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes dhe të marrë kopje të tyre. Brenda pesë ditëve nga paraqitja e kërkesës, Këshilli i siguron magjistratit kushtet për njohjen me dosjen dhe i vë në dispozicion kopje të dokumenteve.”.

2. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. E drejta e aksesit me dosjen mund të kufizohet vetëm nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të rëndë dhe të pariparueshëm ndaj interesave të mëposhtëm:

a) të drejtave themelore të një personi tjetër; ose

b) sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni në fuqi për informacionin e klasifikuar; ose

c) parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;

ç) barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së procesit gjyqësor.

E drejta e aksesit kufizohet për atë kohë sa ekzistojnë shkaqet e mësipërme. Në çdo rast, magjistrati ose përfaqësuesi i tij ka akses në dosje para se Këshilli të marrë vendimin.”.

Neni 22

Neni 152, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 152

Pezullimi në rastin e procedimit disiplinor

1. Kur Këshilli krijon bindjen se vazhdimi në detyrë i magjistratit, për të cilin është paraqitur kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor, sipas

nenit 138, të këtij ligji, dëmton rezultatin e procedimit disiplinor, pengon konkluzionin e tij të drejtë ose të rregullt, ose diskrediton rëndë pozitën dhe figurën e magjistratit, mund të vendosë pezullimin e tij nga detyra.

2. Pezullimi, sipas këtij neni, zgjat deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Këshilli mbi kërkesën për procedim disiplinor, me përjashtim të rastit kur Këshilli vendos të revokojë pezullimin, sipas nenit 156, të këtij ligji.”.

Neni 23

Në nenin 153, shkronjat “c” dhe “ç”, shfuqizohen.

Neni 24

Neni 156, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 156

Kufijtë e kohëzgjatjes së pezullimit

1. Pezullimi i magjistratit, i parashikuar në nenet 151 dhe 152, të këtij ligji, vendoset për një periudhë të caktuar kohe dhe nuk mund të vazhdojë nëse arsyet e pezullimit, të parashikuara në këto nene, pushojnë së ekzistuari.

2. Këshilli kryesisht ose me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë apo të magjistratit mund të rishikojë pezullimin e parashikuar në nenet 151 dhe 152, të këtij ligji, dhe vendos sipas rastit:

a) ndryshimin e kohëzgjatjes së pezullimit;

b) revokimin e pezullimit; ose

c) lënien në fuqi të pezullimit.

Neni 25

Dispozitë kalimtare

1. Deri në miratimin nga këshillat të akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të magjistratëve dhe të realizimit të procedurave të vlerësimit, sipas këtij ligji, por jo më vonë se afati i caktuar për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve, emërimi i kandidatëve të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, që sipas ligjit është parësor, nuk do të ndërvaret nga përfundimi i procedurave të transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë për magjistratët.



2. Për shpalljen e pozicioneve të lira për kandidatët për magistrat të diplomuar në Shkollën e Magistraturës, në çdo rast, këshillat vlerësojnë mbarëvajtjen e sistemit të drejtësisë dhe, në veçanti, nevojat urgjente të gjykatave dhe prokurorive në këndvështrim të funksionalitetit të tyre.

3. Për procedurat e transferimit paralel dhe/ose të ngritjes në detyrë të magistratëve që kandidojnë gjatë kësaj periudhe kalimtare, këshillat miratojnë dhe zbatojnë rregulla të posaçme për vlerësimin etik dhe profesional të tyre; për kriteret e renditjes së magistratëve me pikë të barabarta vlerësimi; për kriteret e vlerësimit të përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë dhe për procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta, të tilla që respektojnë objektivitetin, transparencën dhe efektivitetin e këtij procesi.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.7.2019

Shpallur me dekretin nr.11249, datë 5.8.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11249, datë 5.8.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

LIGJ
Nr. 54/2019

**PËR NISMËN LIGJVËNËSE TË
ZGJEDHËSVE NË REPUBLIKËN
E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi dhe objekti i ligjit

1. Ky ligj vendos procedurat për ushtrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, të sanksionuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

2. Nisma ligjvënëse e zgjedhësve synon përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse dhe realizohet nëpërmjet propozimit të projektligjeve.

Neni 2
Parimet bazë

1. Ndalohet çdo lloj kufizimi për të marrë pjesë në procesin e propozimit të projektligjeve, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Procesi i nismës ligjvënëse zhvillohet në respektim të të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë të së drejtës për t’u organizuar lirisht, të lirisë së shprehjes dhe lirisë së shtypit, lirisë së lëvizjes brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të së drejtës për t’u informuar.

Neni 3
Përkufizime

1. “Afat kohor” është koha e llogaritur në ditë pune, brenda së cilës realizohen procedurat e parashikuara në këtë ligj.

2. “Fletët e mbledhjes së nënshkrimeve” janë fletë tip për mbledhjen e nënshkrimeve të mbështetësve të nismës, të miratuara nga



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. “Grupi i mbledhjes së nënshkrimeve” është struktura përgjegjëse për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse të nismës, në mjediset publike dhe private.

4. “Memorandum bashkëpunimi” është marrëveshja paraprake ndërmjet organizatave të shoqërisë civile ose ndërmjet tyre e shtetasve që mbështesin nismën, që përcakton rregullat e koordinimit dhe të mbarëvajtjes në tërësi të procesit të nismës, deri në depozitim të nismës në Kuvendin e Shqipërisë.

5. “Mjedise të mbledhjes së nënshkrimeve” janë hapësirat publike ose private, me adresë dhe të numërtuara, ku realizohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve të mbështetësve të nismës.

6. “Nismë ligjvënëse e zgjedhësve” është propozimi në formë të shkruar i një projektligji, i nënshkruar nga jo më pak se 20 000 zgjedhës, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë.

7. “Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës” janë strukturat që përfaqësojnë nismëtarët në të gjitha veprimtaritë para shtetasve të tjerë, institucioneve, si dhe Kuvendit të Shqipërisë.

8. “Regjistrimi i nismës ligjvënëse të zgjedhësve” është procesi i regjistrimit formal të nismës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas paraqitjes së kërkesës nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës.

9. “Verifikim i nënshkrimeve” është procesi i verifikimit të fletëve të nënshkrimeve, nënshkrimeve elektronike, si dhe i të dhënave të mbështetësve të nismës ligjvënëse, që realizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të këtij ligji.

10. “Zgjedhës” është çdo shtetas me të drejtë vote, sipas nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

11. “Zgjedhës të asistuar” janë mbështetësit e nismës ligjvënëse që, për shkak të pamundësive fizike, asistohen nga familjarët apo shtetas të tjerë për të shprehur vullnetin e tyre pro nismës.

Neni 4

E drejta për nismën ligjvënëse

1. Çdo zgjedhës mund të marrë pjesë dhe gëzon të drejta të barabarta në procesin e nismës ligjvënëse.

Faqe| 8726

2. Në çdo rast, nisma ligjvënëse nënshkruhet nga jo më pak se 20 000 zgjedhës, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

Neni 5

Hartimi dhe propozimi i nismës ligjvënëse

1. Zgjedhësit ushtrojnë të drejtën e nismës ligjvënëse përmes hartimit dhe propozimit të një projektligji në Kuvendin e Shqipërisë.

2. Projektligji që propozohet në Kuvend hartohet në përputhje me Kushtetutën, rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe standardet ligjore për hartimin e akteve normative.

3. Kuvendi e shqyrton nismën ligjvënëse të zgjedhësve në përputhje me parashikimet e Rregullosës së Kuvendit.

4. Në rastin e mosmiratimit nga Kuvendi, nisma ligjvënëse mund të paraqitet përsëri për t’u shqyrtuar në Kuvend, por jo më parë se 6 muaj nga data e mosmiratimit.

Neni 6

Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse të zgjedhësve

1. Zgjedhësit që iniciojnë një nismë ligjvënëse përfaqësohen nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës.

2. Në rastin kur nisma ligjvënëse inicohet nga individë, ata përzgjedhin një përfaqësi të nismës.

3. Në rastin kur nisma ligjvënëse inicohet nga një ose disa organizata të shoqërisë civile, nisma përfaqësohet nga komiteti përfaqësues, ku secila prej organizatave ka të drejtë të caktojë një përfaqësues.

4. Në rastet kur nisma ligjvënëse inicohet nga individë në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, përfaqësimi realizohet nga komiteti përfaqësues i nismës, i cili përbëhet nga një deri në tre anëtarë të zgjedhur nga grupi i individëve, si dhe nga një përfaqësues për çdo organizatë të shoqërisë civile.

5. Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës është përgjegjës për:

a) fillimin dhe mbarëvajtjen e të gjithë procesit të nismës ligjvënëse të zgjedhësve;



b) koordinimin dhe komunikimin me institucionet përgjegjëse;

c) respektimin e plotë të së drejtës së zgjedhësve për t'u informuar;

ç) përfaqësimin e interesave të iniciatorëve në raport me të tretët.

6. Përfaqësia/Komiteti përfaqësues, në emër të nismëtarëve të nismës ligjvënëse, paraqet përpara Kuvendit të Shqipërisë projektligjin, të cilin mund ta tërheqë përpara miratimit në parim në seancë plenare.

7. Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës informon publikun për qëllimin dhe përmbajtjen e nismës, aktivitetet publike që do të zhvillohen për njohjen e nismës, rregullat e organizimit të përfaqësuesve të nismës dhe mbështetësve të saj, si dhe çdo informacion tjetër që gjykohej i nevojshëm për informimin e publikut.

8. Përfaqësia/Komiteti përfaqësues mund të publikojë në faqen zyrtare të nismës, ose në mjete të tjera të informimit publik, listat e grupeve të mbledhjes së nënshkrimeve, vendet përkatëse të mbledhjes së tyre, si dhe të dhënat që përmbajnë fletët tip të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për mbledhjen e nënshkrimeve, sipas nenit 10 të këtij ligji.

Neni 7

Financimi

1. Shpenzimet për përgatitjen e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, si dhe për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve përballohen nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse.

2. Nismëtarët përcaktojnë paraprakisht mënyrën e mbulimit të shpenzimeve, sipas pikës 1, të këtij neni, si dhe të çdo shpenzimi tjetër të nevojshëm për nismën ligjvënëse, nëpërmjet memorandumeve të bashkëpunimit.

3. Burimet dhe masa e financimit të nismës ligjvënëse bëhen periodikisht publike në faqen zyrtare të nismës dhe raporti përfundimtar i financimit të nismës publikohet jo më vonë se dita kur nisma depozitohet në Kuvend.

Neni 8

Caktimi dhe miratimi i mjediseve për mbledhjen e nënshkrimeve

1. Mbledhja e nënshkrimeve për një nismë ligjvënëse bëhet në mjedise publike ose private, të cilat caktohen me vendim të kryetarit të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, me propozim të përfaqësisë/komitetit përfaqësues të nismës.

2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton mjediset publike dhe private ku do të bëhet mbledhja e nënshkrimeve, duke zbatuar rregullin që të ketë një vend publik/privat për jo më shumë se 5 000 zgjedhës.

3. Kërkesa për miratimin e mjediseve publike dhe private për mbledhjen e nënshkrimeve paraqitet përpara kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës.

4. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr vendim jo më vonë se 20 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës, sipas pikës 3 të këtij neni.

5. Në rast se kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk merr vendim brenda afatit të përcaktuar në pikën 4, të këtij neni, mjediset për mbledhjen e nënshkrimeve përcaktohen nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës. Në çdo rast, përcaktimi i mjediseve duhet të respektojë ruajtjen e rendit publik dhe zhvillimin normal të veprimtarisë së institucioneve.

6. Vendndodhja e mjediseve të mbledhjes së nënshkrimeve bëhet publike nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës, përmes njoftimit në faqen e internetit të nismës ligjvënëse, si dhe në mjediset e jashtme të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore.

Neni 9

Grupet e mbledhjes së nënshkrimeve

1. Mbledhja e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve realizohet nga grupet e mbledhjes së nënshkrimeve në mjediset publike dhe private të përcaktuara sipas këtij ligji.

2. Grupet e mbledhjes së nënshkrimeve përbëhen nga jo më pak se dy anëtarë, të cilët caktohen nga përfaqësia ose komiteti përfaqësues i nismës, sipas rregullave të parashikuara në



memorandumet e bashkëpunimit të nënshkruara për këtë qëllim.

Neni 10

Fletët për mbledhjen e nënshkrimeve

1. Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse të shtetasve paraqet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një kërkesë me shkrim për pajisjen me fletët tip të mbledhjes së nënshkrimeve.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me vendim, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës, sipas pikës 1, të këtij neni, modelin e fletës tip të mbledhjes së nënshkrimeve dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, në një format të shkarkueshëm.

3. Fleta tip e mbledhjes së nënshkrimeve, në një rën anë përmban informacionin mbi nismën ligjvënëse që do t'i propozohet Kuvendit, qëllimin dhe një shpjegim të përmbledhur të saj, si dhe të dhëna për përfaqësinë/komitetin përfaqësues të nismës. Në anën tjetër, fleta e mbledhjes së nënshkrimeve përmban:

- a) numrin rendor;
- b) gjenealogjetet e zgjedhësit që mbështet nismën;
- c) vendin dhe datën e lindjes;
- ç) numrin e kartës së identitetit apo të pasaportës së zgjedhësit;
- d) kolonën për nënshkrimet e zgjedhësve;
- dh) hapësirën përkatëse për emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të grupit të mbledhjes së nënshkrimeve që përfshihen në procesin e mbledhjes së nënshkrimeve, ku ata nënshkruajnë për faktin që kanë realizuar këtë proces.

4. Anëtarët e grupit të mbledhjes së nënshkrimeve sigurohen që qytetarët të nënshkruajnë vetëm një herë dhe vetëm pasi të kenë plotësuar informacionin e kërkuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Nëse për shkak të pamundësisë fizike një zgjedhës nuk mund të nënshkruajë, një anëtar i familjes ose një person që e asiston nënshkruan fletën në prani të tij, sipas udhëzimeve të dhëna prej tij. Në këtë rast, nga grupi i mbledhjes së nënshkrimeve mbahet një procesverbal i veçantë ku evidentohet rasti, nënshkruhet prej tyre dhe depozitohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, së bashku me fletën tip të mbledhjes së nënshkrimeve.

6. Të dhënat e plotësuar nga zgjedhësit në fletën për mbledhjen e nënshkrimeve përbëjnë të dhëna personale dhe mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11

Procedura të veçanta

1. Nëse një zgjedhës, për arsye shëndetësore, nuk është në gjendje të shkojë në vendin e mbledhjes së nënshkrimeve, grupi i mbledhjes së nënshkrimeve, bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga vetë zgjedhësi, ose personi që e asiston, merr nënshkrimin në vendin ku ndodhet. Në çdo rast, kërkesa i paraqitet grupit të mbledhjes së nënshkrimeve jo më vonë se 24 orë para përfundimit të afatit të mbledhjes së tyre. Kërkesa i bashkëngjitet fletës së mbledhjes së nënshkrimeve dhe depozitohen së bashku në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

2. Mbledhja e nënshkrimeve të zgjedhësve që ndodhen të izoluar për arsye sigurie, pasi konsiderohen të dyshuar, janë akuzuar ose janë duke u gjykuar për kryerjen e një vepre penale, ose janë duke vuajtur dënimin, realizohet në përputhje me procedurën e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, në institucionin e sigurisë, bazuar në kërkesat me shkrim që këta persona i dërgojnë përfaqësisë ose komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse nëpërmjet administratës së institucionit përkatës.

3. Zgjedhësit, të cilët banojnë jashtë territorit shqiptar gjatë mbledhjes së nënshkrimeve mund të nënshkruajnë fletët përkatëse në ambasadat ose postet konsullore të Republikës së Shqipërisë. Vendi dhe koha e mbledhjes së nënshkrimeve përcaktohen nga drejtuesi i zyrës përfaqësuese përkatëse dhe njoftohen në mënyrën që siguron akses të plotë ndaj informacionit për shtetasit shqiptarë.

4. Përfaqësia/Komiteti përfaqësues i nismës siguron bashkëpunimin me institucione të tjera shtetërore, me qëllim që të lehtësojnë procesin e mbledhjes së nënshkrimeve për kategoritë e veçanta të personave që mbështesin nismën.



Neni 12

Mbledhja e nënshkrimeve elektronike

1. Mbledhja e nënshkrimeve në mënyrë elektronike kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik, dokumentin elektronik dhe atë për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

2. Në mbledhjen e nënshkrimeve elektronike respektohen, për aq sa është e mundur, kërkesat e pikës 3, të nenit 10, të këtij ligji, për të dhënat që duhet të përmbajë fleta tip e mbledhjes së nënshkrimit.

Neni 13

Afati për mbledhjen e nënshkrimeve

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim të përfaqësisë/komitetit përfaqësues të nismës për pajisjen me fletët tip për mbledhjen e nënshkrimeve, përcakton me vendim, sipas propozimit të përfaqësisë/komitetit përfaqësues, periudhën kohore gjatë së cilës zhvillohet procesi i mbledhjes së nënshkrimeve, në vendet publike dhe private, si dhe i nënshkrimeve elektronike.

2. Fletët e mbledhjes së nënshkrimeve depozitohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës, jo më vonë se pesë ditë pas përfundimit të procesit të mbledhjes së tyre, së bashku me dokumentacionin shoqërues të kërkesave të zgjedhësve që nuk mund të nënshkruajnë në vendet publike, procesverbalet e grupeve mbështetëse të nismës për zgjedhësit që, për shkak të paaftësive fizike, nuk mund të nënshkruajnë vetë, si dhe mbledhjen e nënshkrimeve në mënyrë elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 14

Verifikimi i nënshkrimeve

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon nënshkrimet, si dhe saktësinë e dokumenteve identifikuese të mbështetësve të nismës, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Zgjedhor për verifikimin e nënshkrimeve dhe në legjislacionin në fuqi për nënshkrimin elektronik,

brenda 30 ditëve nga depozitimi i tyre, dhe merr një nga vendimet e mëposhtme:

- a) regjistron nismën ligjvënëse të zgjedhësve;
- b) cakton një afat kohor për plotësimin ose korrigjimin e pasaktësive të nënshkrimeve;
- c) refuzon regjistrimin e nismës nëse nga verifikimi rezulton se numri i nismëtarëve që kanë mbështetur nismën, duke depozituar identitetin dhe firmat e tyre, është më i vogël se 20 000 zgjedhës.

2. Nëse është rasti, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të kërkojë informacion shtesë nga institucionet qendrore dhe vendore, si dhe mund të konsultohet me ekspertë.

3. Në rast të mospërputhjes të informacionit që përmbajnë fletët e nënshkrimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ia kthen fletët përfaqësisë/komitetit përfaqësues të nismës, me qëllim korrigjimin e tyre brenda 20 ditëve nga dita e kthimit.

4. Pas ridepozitimit të fletëve të rishikuara, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryen sërish verifikimet përkatëse dhe njofton, brenda 2 ditëve, përfaqësinë/komitetin përfaqësues të nismës ligjvënëse.

5. Në rastin e refuzimit të regjistrimit të nismës ose të fletëve të nënshkrimeve, si dhe në rastin e kthimit të tyre për rishikim, vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të jetë i arsyetuar.

Neni 15

Depozitimi i nismës ligjvënëse në Kuvend

Projektligji i plotë së bashku me relacionin që përshkruan dhe analizon qëllimin që kërkon të arrijë dhe që për ligj shpenzimet financiare për zbatimin e tij, si dhe vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve depozitohen në Kuvendin e Shqipërisë nga përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

Neni 16

Ankimi ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për refuzimin e regjistrimit të fletëve



të nënshkrimeve ose për refuzimin e regjistrimit të nismës, përfaqësia/komiteti përfaqësues i nismës mund të paraqesë ankim në gjykatën administrative.

Neni 17
Sanksionet

1. Shkelja e procedurave dhe afateve që lidhen me mbledhjen e nënshkrimeve dhe regjistrimin e nismës nga personat përgjegjës përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

2. Kur personat e ngarkuar nga ky ligj me mbledhjen e nënshkrimeve përfshijnë të dhëna të rreme, mbajnë përgjegjësi penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjykon shkeljet administrative, sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

4. Vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të ankimohen në gjykatën administrative.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.7.2019.

Shpallur me dekretin nr.11250, datë 5.8.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11250, datë 5.8.2019
PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 54/2019 “Për nismën ligjvënësë të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET

Nr. 11246, datë 31.7.2019

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë së tyre, personave të mëposhtëm:

1. Vasil Miallaq Stojani
2. Rudolf Gëzim Dika
3. Silvi Bujar Harri
4. Herolind Mitat Sokoli
5. Valbon Rifat Qamilji
6. Ertilla Lekë Krasniqi (Shpani)
7. Zamir Enver Kraja
8. Harald Ndrëçim Bicakani
9. Liljana Enver Kadilli
10. Sokol Prek Peraj
11. Victoria Sokol Peraj
12. Noel Sokol Peraj
13. Oltjona Simon Gjini
14. Qazim Qemal Doda
15. Pranvera Ismail Ebeling (Aga)
16. Adjola Sokrat Kuçi (Findiku)
17. Emrjona Arbër Delilaj-Hochmuth (Delilaj)
18. Marius Ilirjan Alfred Josef Pfurtscheller
19. Pranvera Binak Baraj (Ahmetaj)
20. Alma Tosum Tola (Sula)
21. Besarta Ilmi Prengzaj
22. Marsela Shyqyri Hoxha (Kila)
23. Noel Arjon Bledar Hoxha
24. Vilma Mina Kina
25. Aleksandër Eduard Haxhi
26. Ondina Saip Beçoku
27. Ardita Zenun Ekinci (Dushaj)
28. Argjend Remzi Xhaferaj
29. Amla Argjend Xhaferaj
30. Edona Lutfi Xhaferaj (Noka)
31. Ylber Riza Isakaj



32. Sotiris Petrit Lamaj
33. Eralda Kujtim Seferi
34. Iva Petrit Lako (Tartari)
35. Isabell Mariglen Lako
36. Teuta Lulzim Bilbili Hildebrandt (Bilbili)
37. Elton Mirko Brajoviq
38. Hateme Ilmi Male (Hoxha)
39. Novruz Muhamet Male
40. Valentin Thanasi Tangu
41. Tedina Izedin Çela
42. Kozmas (Kosmas) Teodor (Theodoros)

Kota (Kotas)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 11247, datë 31.7.2019

**PËR DHËNIE TË SHETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë së tyre personave të mëposhtëm:

1. Avni Hazir Duraku
2. Arjeta Selim Veseli (Berisha)
3. Rexhep Hyrmet Ibrahim
4. Mamica Haki Gjondedaj
5. Shqiponjë Ismet Shala
6. Blerton Mukim Sheji
7. Njomza Dulah Emini
8. Alban Skender Çeku
9. Genc Rifat Çeku
10. Rasim Bajram Mrlaku
11. Albane Hamit Mrlaku (Krasniqi)
12. Mario Camillo Messuri
13. Leonarde Krist Pergega

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM
Nr. 17, datë 30.7.2019

**PËR DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10,
DATË 15.5.2019, “PËR PROCEDURAT E
APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE, NË PROGRAMET E
STUDIMEVE ME KARAKTER
PROFESIONAL, SI DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE,
NË INSTITUCIONET E ARSIMIT
TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. Titulli i udhëzimit nr. 10, datë 15.5.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë”, ndryshon si më poshtë:

“Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”.

II. Pas kreut IV, shtohen kërret IV/1, IV/2, IV/3, IV/4, IV/5 dhe IV/6, si më poshtë:



“KREU IV/1

PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË
APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË
STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË
DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË
PROGRAMET E STUDIMEVE ME
KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË
PROGRAMET E INTEGRUARA TË
STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME
KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E
ARSIMIT TË LARTË

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin studimet në një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, kanë të drejtë të aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

2. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në shtojcën nr. 10 të këtij udhëzimi.

3. Kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për vitin përkatës akademik.

4. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda ose jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtut cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik që studenti është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016–2017 dhe në vijim.

5. Nuk mund të pranohen aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Kandidatët që aplikojnë për transferim të studimeve apo për program të dytë studimi duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë për programet e studimit për të cilët aplikojnë. Kandidati nuk duhet të jetë duke ndjekur një tjetër program studimi.

6. Aplikimi për transferim studimesh, mund të bëhet nga një program studimi i njëjtë ose i ngjashëm i të njëjtut cikël edhe lloj, të ndjekur nga kandidati në IAL-të publike ose në IAL-të jopublike të licencuara dhe të akredituara për programin përkatës të studimit, vendase apo të huaja.

7. Nuk mund të kryhen transferime studimesh nga një nivel cikli studimesh apo të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në një tjetër. Në këtë kuadër nuk mund të kryhen transferime studimesh nga programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional në programe të ciklit të parë “Bachelor” dhe në programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave”.

8. Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për transferim të studimeve, paraqesin, pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve, dokumentet si më poshtë:

a) kërkesën drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin do të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës nr. 6);

b) planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse;

c) vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur;

d) studentët që transferojnë studimet e tyre nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, planin e plotë të programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse dhe listën e notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, duhet t'i dorëzojnë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin;

d) fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë publikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në drejtorinë rajonale të arsimit parauniversitar/ zyrën vendore të arsimit parauniversitar (DRAP/ZVAP) përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) dy fotografi personale;



g) kopje të mandatpagesës.

9. Në momentin e regjistrimit përfundimtar me dokumentacion në IAL (pas shpalljes fitues), kandidati paraqet edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i. emrin, atësinë, mbiemrin;

ii. datëlindjen;

iii. vendlindjen;

iv. shtetësinë;

v. numrin e matrikullimit që ka pasur në IAL-në përcjellëse;

vi. emrin e shkollës së mesme/IAL-së ku ka kryer shkollën//studimet përpara ndjekjes së këtij programi studimi;

vii. ID-në e Maturës Shtetërore / nr. Regj. të veçantë¹;

viii. numrin personal të identitetit;

ix. datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja;

x. emërtimin e programit të studimit dhe fakultetit përkatës;

xi. ciklin dhe formën e studimit;

xii. datën e ndërprerjes së studimeve.

10. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi paraqet dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarive mësimore që mbulojnë programin përkatës të studimeve:

a) kërkesa drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin aplikon për program të dytë studimi (ose formulari i aplikimit sipas shtojcës 6);

b) kopje e noterizuar e diplomës së studimeve universitare të kryera më parë, të shoqëruar me suplementin e diplomës;

c) vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse);

d) fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (kandidati që ka përfunduar shkollën e mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga

drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

e) fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

f) dy fotografi personale.

Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

11. IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

12. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe në faqet *web* përkatëse, e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr.8, të këtij udhëzimi.

IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

13. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehën me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

14. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

¹ Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme para vitit 2006.



15. Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

16. IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (në vijim “QSHA”) listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr.1, të këtij udhëzimi.

KREU IV/2

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NGA REPUBLIKA E KOSOVËS, KANDIDATËVE ME ORIGJINË SHQIPTARE NGA MAQEDONIA E VERIUT, MALI I ZI, PRESHEVA, MEDVEGJA DHE BUJANOVCI, KANDIDATËVE ME STATUSIN E PERSONIT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, ME STATUSIN E JETIMIT, SI DHE TË KANDIDATËVE TË KOMUNITETIT ROM DHE EGJIPTIAN, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat

e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-të.

2. Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimit, aplikojnë pranë IAL-ve respektive, deri më datën e përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Në të njëjtën datë, IAL-të shpallin listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurs, të cilat bëhet publike në mjediset e IAL-ve dhe faqet elektronike zyrtare. Konkurset e pranimit zhvillohen në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

3. Aplikimi të kryhet vetëm nga kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin e Këshillit të

Ministrave për vitin e ri akademik, si dhe plotësojnë kriteret shtesë të pranimit të vendosura nga vetë IAL-të për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.

5. Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, përpara aplikimit, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon.

6. Aplikimi për programet e studimit në IAL dërgohet me postë pranë sekretarive mësimore ose depozitohet në zyrën e protokollit të njërive kryesore të IAL-ve.

7. Sekretaritë mësimore mbajnë regjister për aplikimet e depozituara. Me depozitim të aplikimit, njësitë kryesore përlogarisin mesataren për çdo kandidat në përputhje me përcaktimet në vendimin e Këshillit të Ministrave për vitin e ri akademik. Kandidatët të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare njoftohen nga sekretaritë mësimore për ndërprerjen e aplikimit.

8. Kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit



rom dhe egjiptian, në momentin e aplikimit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kandidatët nga Republika e Kosovës, me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dorëzojnë:

i. formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;

ii. kopje të dokumentit të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që vërteton se diploma e arsimit të mesëm është njohur, të shoqëruar me fotokopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave;

iii. në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën sipas shtojcës nr. 4, të këtij udhëzimi, si dhe kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet. Përlllogaritja e notave do të kryhet sipas udhëzimit nr. 44, datë 21.8.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”, i ndryshuar. Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri, dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore;

iv) dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë). Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

v) dy fotografi;

vi) kopje të mandatpagesës.

b) kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian, dorëzojnë:

i. formularin e aplikimit sipas formatit të shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.

ii. kopje të diplomës/dëftesës, të shoqëruar me listën e notave.

iii. në momentin e regjistrimit kandidati fitues duhet të dorëzojë pranë IAL-së, deklaratën sipas shtojcës nr.5, të këtij udhëzimi si dhe kopje të njësuar me origjinalin, të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit. Kandidati që ka përfunduar shkollën e

mesme në Republikën e Shqipërisë përpara vitit 2011, të dorëzojë kopje të njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme. Në mungesë të diplomës së Maturës Shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë, respektivisht, vërtetim notash të Maturës Shtetërore të lëshuar nga QSHA-ja dhe dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të vërtetuar në DRAP/ZVAP-në përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit;

iv. fotokopje të dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

v. dy fotografi personale;

vi. kopje të mandatpagesës;

c) kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të njësuar me origjinalin të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (në vijim “KMCAP”);

d) kandidatët me statusin e jetimit, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe kopje të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

e) kandidatët romë dhe egjiptianë, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian. Për përzgjedhjen e kandidatëve romë dhe egjiptianë, IAL-të marrin edhe ekspertizën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;

f) në rastet e aplikimeve nga kandidatët nga kategori të tjera të personave me aftësi të kufizuar, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 8, të këtij kreu duhet të dorëzojnë dhe kopje të vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).

Njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre.

9. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre, si dhe për çdo program



studimi që ofrojnë, ato publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. Gjithashtu, IAL-të në datën e përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit brenda tre ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

11. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

12. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

13. Pas datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve, për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

14. IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit.

15. IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

KREU IV/3

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE SHTETAS TË HUAJ, NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË PROGRAMET E STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në IAL, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë, në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-ja.

2. Kandidatët shtetas të huaj duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe të jenë të pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të këtij niveli arsimor, nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga IAL-të, për programet e studimit për të cilët aplikojnë.

3. Kandidatët shtetas të huaj, përpara aplikimit kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për çdo program studimi, sipas përcaktimit të IAL-së, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë në llogari të IAL-së pranë të cilit aplikon. Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

4. Kandidatët kanë të drejtë të aplikojnë deri në 10 (dhjetë) programe studimi në një ose disa IAL.

5. Studentët e huaj duhet të paraqesin pranë IAL-ve dokumentacionin e mëposhtëm:

a) formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 2, të këtij udhëzimi;

b) kopje të diplomës/dëftesës dhe listës së notave, të njehsuar nga QSHA-ja;

c) fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);



d) dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe, mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe;

e) dy fotografi personale;

f) kopjen e mandatpagesës;

g) autorizimin për trajtimin e të dhënave personale sipas shtojcës nr. 4, të këtij udhëzimi.

6. IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kritereve të përcaktuara nga ana e tyre. IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. IAL-të në datën e përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi publikojnë në mjedise të dukshme dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën jo përfundimtare të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit brenda tri ditëve kalendarike nga data e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave. Vendimet e IAL-ve ankohen në gjykatën kompetente.

8. IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, në datën e përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

9. Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Regjistrimi i kryer konsiderohet përfundimtar dhe kandidati nuk mund të heqë dorë për tu regjistruar në një program tjetër studimi.

10. Pas datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, sekretaritë mësimore në njësitë kryesore të IAL-ve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Kandidatët e shpallur

fitues dhe të regjistruar në një program tjetër studimi nuk ftohen për të plotësuar këto kuota.

11. IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi përfundojnë regjistrimin e të gjithë kandidatëve fitues.

12. Sekretaritë mësimore të IAL-ve do të pranojnë dokumentacionin për të gjithë kandidatët fitues sipas dokumenteve të dorëzuara në momentin e aplikimit.

13. Procedurat e regjistrimit për programet e përbashkëta të ciklit të parë dhe të dytë të integruar:

a) zhvillimi i procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit objekt të këtij udhëzimi, në IAL-të që i zhvillojnë këto programe, si programe të përbashkëta studimi, që përfundojnë me një diplomë të përbashkët, të dyfishtë ose të shumëfishtë, në bashkëpunim me IAL-të e vendeve të BE-së, kryhet sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga vetë IAL-të;

b) njohja e dokumentacionit të kandidateve fitues të huaj, në këto programe studimi, mund të kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë dhe përpara sezonit të parë të provimeve. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA-ja kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi ia komunikon IAL-së;

c) kandidatët që aplikojnë në programet e përbashkëta të studimit e paraqesin aplikimin e tyre pranë IAL-se përkatëse. Të dhënat e tyre i dërgohen QSHA-së nga IAL-ja në përfundim të procesit të regjistrimit të aplikimeve. Pas zhvillimit të konkurseve/testimeve të pranimit, IAL-ja i dërgon QSHA-së listat e fituesve dhe të dhënat e tyre, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të nevojshëm për zhvillimin e procedurave të njohjes së diplomës;

d) kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm në institucione arsimore në të njëjtën gjuhë të huaj që zhvillohet edhe programi i përbashkët i integruar i studimit i ciklit të dytë i IAL-së ku aplikon, përjashtohen nga detyrimi i mbrojtjes së kësaj gjuhe sipas përcaktimeve në pikën 4, të nenit 76, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;



e) sekretaritë mësimore të IAL-ve mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit me të dhënat mbi datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e kandidatëve të regjistruar. Kandidati, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e studimit, për atë vit akademik;

f) IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja cregjistrimin tyre.

KREU IV/4

PRANIMET NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE”/“MASTER I ARTEVE”

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike dhe jopublike, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

2. Brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, IAL-të publike dhe jopublike, të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (*web*) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve publike

dhe jopublike, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

5. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (*web*), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi për IAL-të publike dhe jopublike.

6. Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

7. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”/“Master i arteve”, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga ato, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe të bëra publike paraprakisht.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit të studentit, dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose;

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë QSHA-së brenda muajit të përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomë, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës;

b) diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të



njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar”, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (origjinal ose fotokopje të saj, të njësuar me origjinalin, të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtorja e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

c) formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 5, të këtij udhëzimi;

d) fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

e) dy fotografi personale.

10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) dëshmi e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse;

b) Curriculum Vitae;

c) deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së;

b) kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

c) kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë dhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

12. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i bën me dije IAL-ve mbi mospajisjen me numër matrikullimi.

15. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si dhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecures normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

16. IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi.



Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matricullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.

KREU IV/5

PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR TRANSFERIM TË STUDIMEVE DHE PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI, NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

1. Kandidatët që kërkojnë të ndjekin një program të dytë studimi apo të transferojnë studimet në programet e ciklit të dytë të studimeve kanë të drejtë të aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

2. Kandidatët që aplikojnë në IAL, për program të dytë studimi apo transferim studimesh kanë të drejtë të aplikojnë deri në 5 programe studimi përpara fillimit të vitit akademik dhe sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzim.

3. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për program të dytë studimi, kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë “Bachelor” apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit dhe i akredituar në momentin e diplomimit të studentit; ose

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor”, ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë QSHA-së.

4. Kanë të drejtë të aplikojnë në programet e ciklit të dytë për transferim studimesh të gjithë kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në germën “a”, të pikës 3, të këtij kreu, në një program të ciklit të parë “Bachelor”, apo në një program të

integruar të studimeve të ciklit të dytë, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë brenda ose jashtë vendit të akredituar në momentin e transferimit;

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor”, apo në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë, kanë kryer njësimin e diplomës pranë QSHA-së, si dhe kanë ndjekur një program studimi të ciklit të dytë të akredituar në momentin e transferimit brenda ose jashtë vendit.

5. Transferimi i studimeve në ciklin e dytë mund të bëhet në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm të të njëjtit cikël dhe lloj sipas kriterëve të vendosura dhe shpallura publikisht paraprkisht nga IAL-ja.

6. IAL-të nuk mund të pranojnë aplikime për transferime gjatë vitit akademik. Transferimi i studimeve do të kryhet në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara në këtë udhëzim.

7. Kandidati që aplikon për program të dytë studimi në ciklin e dytë të studimeve paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Për diplomat e fituara jashtë vendit, të diplomës së ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës;

b) diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njësuar me origjinalin, e konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, datë 3.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 78, datë 8.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar”, paraqesin dëftesën e pjekurisë (origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin, të konfirmuar



nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP).

Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin publikatë të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga institucioni përkatës arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP/ZVAP), ose dokumentin e lëshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listën e notave;

c) formularin i aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr. 8, të këtij udhëzimi;

d) fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);

e) dy fotografi personale.

8. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

b) Curriculum Vitae;

c) deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi;

9. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për transferim studimesh:

a) kërkesën drejtuar IAL-së për programin e studimit, në të cilin kërkon të transferojë studimet (ose formulari i aplikimit);

b) planin e plotë të programit të studimit nga ku transferohet;

c) vërtetim të listës së notave, krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer në ciklin e dytë të studimeve, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin eventuale të lëndëve të programit të studimit të ndjekur, si dhe programeve/syllabuseve përkatëse të lëndëve të shlyera.

10. Kandidati duhet të paraqesë në momentin e regjistrimit edhe dokumentin origjinal të çregjistrimit, nga IAL-ja nga ku transferohet, i cili përmban:

i. emrin, atësinë, mbiemrin;

ii. datëlindjen;

iii. vendlindjen;

iv. shtetësinë;

v. numrin e matrikullimit që ka pasur në programin e studimit të ciklit të parë;

vi. emërtimin e IAL-së dhe i programit të studimit të ciklit të parë, si dhe forma e studimit;

vii. numrin i matrikullimit, si dhe emërtimi i programit të studimit të ciklit të dytë dhe fakultetit përkatës në IAL-në nga ku transferohet;

viii. ciklin dhe forma e studimit;

ix. datën e regjistrimit në programin e studimit të ofruar nga IAL-ja nga ku transferohet;

x. datën e ndërprerjes së studimeve;

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi:

a) fotokopje e njësuar me origjinalin në Republikën e Shqipërisë të diplomës universitare të ciklit të dytë të studimeve, së bashku me suplementin e diplomës ose listën e notave. Për diplomat e fituara jashtë vendit, duhet të dorëzojë dhe vërtetimin e njohjes në Republikën e Shqipërisë;

b) plani i plotë i programit të studimit përfshirë dhe syllabuset përkatëse, vërtetim i listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për njohjen e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse, nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse.

12. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar, duhet të dorëzojë edhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së;

b) kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar e dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror;

c) kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

13. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione ad hoc sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të



kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (Statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruara paraprakisht nga IAL-ja.

14. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruara nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

15. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i bën me dije IAL-të, mbi mospajisjen me numër matrikullimi.

16. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

17. Komisionet respektive kryejnë renditjen e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh apo program të dytë studimi bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, dhe vlerëson kandidatët me statusin fitues/jo fitues. Këto të dhëna shpallen nga dekanati përkatës në ambientet e fakultetit dhe IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse (*web*), të plotësuara sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr.9, të këtij udhëzimi, respektivisht, për kandidatët që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe për kandidatët që kanë aplikuar për program të dytë studimi.

18. IAL-ja shpall listat e kandidatëve që kanë aplikuar për transferim studimesh dhe ato të kandidatëve që kanë aplikuar për program të dytë studimi në vende të dukshme brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

19. Aplikimet për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në shtojcën

nr. 10, të këtij udhëzimi. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekanati përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe faqet elektronike zyrtare përkatëse(*web*), e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr. 8, të këtij udhëzimi.

IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.

20. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

21. IAL-të shpallin listat përfundimtare me renditjen e kandidatëve, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e tyre, brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

22. Regjistrimi i kandidatit, i cili mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij, kryhet pranë sekretarive mësimore në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

23. IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

24. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.



KREU IV/6

PRANIMET NË CIKLIN E TRETË TË
STUDIMEVE “MASTER EKZEKUTIV”

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv” me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidatëve, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, në IAL-të publike dhe jopublike, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10 të këtij udhëzimi.

2. Brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi, IAL-të publike dhe jopublike, të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqet elektronike zyrtare (web) të IAL-së, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.

3. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda tri ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL-të detyrohen të shprehën me vendim të argumentuar lidhur me ankimimin brenda dy ditëve pune nga data e paraqitjes së ankesave.

4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të IAL-ve publike dhe jopublike, përkatësisht deri në datat e përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

5. IAL-ja shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj elektronike zyrtare (web), listën emërore të kandidatëve të regjistruar brenda datave përkatëse të përcaktuara në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi për IAL-të publike dhe jopublike.

6. Njësitë kryesore të IAL-ve, organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë dhe verifikimin e dokumentacionit të pranimit sipas kuadrit ligjor në fuqi. Procesi menaxhohet dhe monitorohet nga rektoratet.

7. Pranimi, në programet e studimit të ciklit të tretë, me kohë të plotë, “Master ekzekutiv”, sipas kuotave respektive të deklaruara nga IAL-të, realizohet në bazë të përzgjedhjes së bërë nga ato, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe sipas kriterëve të përcaktuara nga njësitë bazë, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë dhe të bëra publike paraprakisht.

8. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, kandidatët që:

a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”, i cili rezulton i licencuar në momentin e regjistrimit dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit; ose

b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”, i licencuar dhe akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njësimin e diplomës pranë QSHA-së brenda muajit të përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi.

9. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Diplomën, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”/“Master i arteve” të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave”/“Master i arteve” të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të tretë në vendin përkatës.

b) Diplomën, ose fotokopje të saj të njësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomës së ciklit të parë të studimeve “Bachelor” të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare të ciklit të tretë në vendin përkatës.

c) Vërtetimin për njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Nëse aplikanti ka fituar një diplomë të një programi studimi të



kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

d) Formularin e aplikimit, sipas formatit të shtojcës nr.5, të këtij udhëzimi.

e) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

f) Dy fotografi personale.

10. Dokumentacion shtesë vetëm për shtetasit e huaj:

a) Dëshminë e njohjes së gjuhës shqipe, fituar në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës (për rastet kur regjistrohet në një program studimi që zhvillohet në gjuhën shqipe), si dhe të gjuhëve të tjera të njohura nga kandidati. Shtetasit e huaj që kanë kombësi shqiptare dhe kanë njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe mund të sjellin çdo dokument nga vendi i origjinës që provon njohjen e gjuhës shqipe. Nga ky detyrim përjashtohen shtetasit e huaj që kanë përfunduar një cikël/program studimi në gjuhën shqipe në institucione të arsimit të lartë në Shqipëri.

b) Shtetasit e huaj që aplikojnë në bazë të marrëveshjeve dypalëshe përjashtohen nga tarifat e shkollimit, në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

c) Curriculum Vitae;

d) Deklaratën sipas, shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.

11. Dokumentacion shtesë vetëm për kandidatët e kategorive të veçanta:

a) Kandidati me statusin e personit me aftësi të kufizuar duhet të dorëzojë edhe fotokopjen e noterizuar të librezës së të verbrit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose kopje të noterizuar të vendimit të KMCAP-së.

b) Kandidati me statusin e jetimit, duhet të dorëzojë dhe fotokopjen e noterizuar të dokumentit që certifikon statusin e jetimit të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

c) Kandidati rom dhe ballkano-egjiptian, duhet të dorëzojë edhe vetëdeklarim ose një dokument që vërteton që është rom apo ballkano-egjiptian.

12. Pranë departamenteve të njësive kryesore të IAL-ve ngrihen komisione *ad hoc* sipas fushave përkatëse, për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë, për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas kategorive dhe përzgjedhjen në bazë të meritës të atyre kandidatëve që plotësojnë

kriteret e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore (statut dhe rregullore) në fuqi, si dhe kriteret për çdo program studimi sipas kuotave përkatëse, të deklaruar paraprakisht nga IAL-ja.

13. Për programet e studimit që parashikojnë konkurs për pranimin e kandidatëve, konkurrimi të zhvillohet pranë IAL-së përkatëse në datat e deklaruar nga IAL-ja respektive, bazuar në aplikimet e paraqitura nga kandidatët sipas afateve të parashikuara në këtë udhëzim. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë mësimore që mbulon programin e studimit ku janë shpallur fitues.

14. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në IAL publike dhe/ose jopublike, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer. QSHA-ja pas verifikimit i bën me dije IAL-të mbi mospajisjen me numër matrikullimi.

15. IAL-të shpallin publikisht hapjen e procedurave të aplikimit, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshëm për aplikim dhe regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecures normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime bëhen pranë fakulteteve respektive dhe IAL-së, si dhe në median e shkruar dhe elektronike.

16. IAL-të brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi dërgojnë pranë QSHA-së listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format EXCEL me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin tyre.

17. Në të gjitha rastet, kandidati duhet të nënshkruajë deklaratën sipas shtojcës nr.4, të këtij udhëzimi.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

**Shtojca nr. 2****Deklaratë**

Unë i nënshtetuesi _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë _____ Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre.

Autorizoj, gjithashtu institucionin e arsimit të lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

3. Deklaroj se jam njohur me këtë udhëzim si dhe plotësoj kriteret e parashikuara në të për të aplikuar për transferim studimesh/program të dytë studimi.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër i
i kandidatit

Firma

Emër Mbiemër
i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma

Vendi: _____ Data: ____ . ____ . ____



Shtojca nr. 3

Data: ____/____/____

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____

e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të parë / profesional / integruar i ciklit të dytë
në LAL _____.

1. Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët

a) me kombësi shqiptare nga trojet (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):

- ☐ Republika e Kosovës;
- ☐ Mal i Zi;
- ☐ Maqedonia e Veriut;
- ☐ Preshevë;
- ☐ Bujanovci;
- ☐ Medvegja;

b) e huaj

Me shtetësi _____

Gjuhë amtare _____

Me arsim të mesëm _____

Adresë aktuale _____

2. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallëm fitues për vitin akademik në vijim.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër kandidatit

Firma



Shtojca nr. 4

Data: ____/____/____

Formular aplikimi

Unë i nënshkruari _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____, e-mail _____
celular _____.

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit _____ në LAL _____.

1. Deklaroj se jam (të shënohet me “x” kategoria):

☐ të tjerë (PAK)

☐ jetim;

☐ Rom;

☐ Egjiptian.

2. Autorizoj institucionet e arsimit të lartë të sipërcituara dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

3. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në njërin nga programet e studimit në të cilin do të shpallej fitues për vitin akademik në vijim.

4. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

5. Deklaroj se jam njohur me Udhëzimin përkatës dhe jam i qartë për procedurat e aplikimit, përzgjedhjes dhe regjistrimit.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitur. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përygjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër kandidatit
Firma



Shtojca nr. 5

Deklaratë

Unë i nënshtetuesi _____, lindur më _____,
me kartë identiteti, pasaportë nr. _____,

1. Autorizoj Institucionin e Arsimit të Lartë _____, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku ka kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore, për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër.

2. Deklaroj se do të regjistrohem vetëm në një nga programet e studimit në të cilin do të shpallam fitues, për vitin akademik në vijim.

3. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

4. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord për sa më sipër.

5. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër, Atësi, Mbiemër i kandidatit

Emër, Atësi, Mbiemër i punonjësit të sekretarisë mësimore

Firma:

Firma:

Vendi: _____

Data: ____ . ____ . ____



Shtojca nr. 6

Data: ____/____/____

Formular aplikimi

Unë i/e nënshkruari/a _____, lindur më _____
 emri atësia mbiemri
 me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit të ciklit të dytë / tretë:

- ☐ “Master profesional”
☐ “Master i shkencave”/ “Master i arteve”
☐ “Master Ekzekutiv”

në _____, në LAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Shtetas shqiptarë, brenda vendit**B. Kandidatë shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit (të shënohet me “x” vendi nga vjen kandidati):**

- ☐ Republika e Kosovës;
☐ Mal i Zi;
☐ Maqedonia e Veriut;
☐ Preshevë;
☐ Bujanovci;
☐ Medvegja;

C. Nga kategoritë e veçanta (PAK, të shënohet kategoria e veçantë të cilës i përket kandidati):**D. Shtetas i huaj**

Gjuha amtare _____ Shtetësia _____

Emri i universitetit _____

6. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në ciklin përkatës të studimit.

7. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shitesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të LAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

8. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

9. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

10. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër i kandidatit

Emër Mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma

Firma



Shtojca nr. 7

Data ____/____/____

Formular aplikimi

Unë i/e nënsbikruari/a _____, lindur më _____
emri atësia mbiemri
me kartë identiteti/pasaportë nr. _____ e-mail: _____, Tel: _____

Kërkoj të regjistrohem në programin e studimit (vendosni një rreth):

- ☐ me karakter profesional 2 – vjeçar
- ☐ ciklit të parë “Bachelor”
- ☐ integruar të ciklit të dytë
- ☐ ciklit të dytë “Master profesional”
- ☐ ciklit të dytë “Master i shkencave” / “Master i arteve”
- ☐ ciklit të tretë “Master ekzekutiv”

në _____, në LAL _____

Deklaroj se aplikoj me kuotat për kandidatët (vendosni një rreth mbi kategorinë përkatëse):

A. Për program të dytë studimi**B. Për transferim studimesh**

1. Deklaroj se jam njohur me parashikimet e Udhëzimit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për pranimet në ciklin përkatës të studimit.

2. Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e tjera shtesë të miratuara në statutin apo rregulloret përkatëse të LAL-së dhe të programit të studimit, si dhe me pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi, dhe jam dakord për sa më sipër.

3. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin e tyre.

4. Autorizoj, gjithashtu Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Institucionin e Arsimit të lartë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u regjistruar, periudhën e studimeve të kryera më parë, dhe çdo lloj verifikimi tjetër që lidhet me sa më sipër, me aplikimin, si dhe me të dhënat e deklaruara në këtë formular.

5. Deklaroj se nuk po ndjek ndonjë program tjetër studimi në institucione të tjera të arsimit të lartë, dhe se nuk do të ndjek njëkohësisht një program tjetër studimi, deri në përfundimin e programit të studimit ku po aplikoj.

6. Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose LAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventalisht edhe organeve kompetente.

Emër Atësi Mbiemër i kandidatit

Emër Mbiemër i punonjësit që pranoi aplikimin

Firma

Firma

**Shtojca nr. 8**

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit të kryer më parë dhe lloji ("Bachelor", PICD)	IAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit ku aplikon për program të dytë dhe lloji ("Bachelor", PICD)	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jo fitues
											Kriteri 1	Kriteri 2	...	Pikët totale	
1															
2															
3															
....															

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	IAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik paraardhës	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit nga transferohet dhe lloji (Bachelor, PICD)	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues/Jo fitues
												Kriteri 1	Kriteri 2	etj	Pikët totale	
1																
2																
3																
....																

**Shtojca nr. 9**

Tabela 1a. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për transferim studimesh në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji	LAL-ja nga transferohet	Viti i studimit i ndjekur në vitin akademik paraardhës	Kreditet (ECTS) të grumbulluara nga kandidati	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) nga transferohet dhe lloji	Viti i studimit ku transferohet	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues / Jo fitues
												Kriteri 1	Kriteri 2	...	Pikët totale	
1																
2																
3																
...																

Tabela 1b. Të dhënat e të gjithë aplikantëve për program të dytë studimi në përfundim të shqyrtimit të komisionit të ekuivalentimit dhe vlerësimit.

nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Datëlindje	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) të kenyer më parë dhe lloji	LAL-ja ku ka përfunduar programin e parë të studimit	Data e diplomimit në programin e parë të studimit	Emërtimi i programit të studimit (Cikli II) ku aplikon për program të dytë dhe lloji	Viti i studimit ku mund të regjistrohet kandidati	Kreditet e njohura	Pikët e akorduara				Statusi i kandidatit Fitues / Jo fitues
											Kriteri 1	Kriteri 2	...	Pikët totale	
1															
2															
....															

*Shtojca nr. 10**Tabela 1: Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit sipas referencave në udhëzim*

Nr.	Referenca në udhëzim	Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit
1.	Kreu IV/1, pika 1	02.09.2019 - 13.09.2019
2.	Kreu IV/1, pika 11	17.09.2019
3.	Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 1	23.09.2019
4.	Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 2	24.09.2019
5.	Kreu IV/1, pika 14	27.09.2019
6.	Kreu IV/1, pika 15, fjalia 1	07.10.2019 - 11.10.2019
7.	Kreu IV/1, pika 15, fjalia 2	18.10.2019
8.	Kreu IV/1, pika 16	15.11.2019
9.	Kreu IV/2, pika 1	20.08.2019 - 30.08.2019
10.	Kreu IV/2, pika 2, fjalia 1	30.08.2019
11.	Kreu IV/2, pika 2, fjalia 3	02.09.2019
12.	Kreu IV/2, pika 9	03.09.2019
13.	Kreu IV/2, pika 11	12.09.2019
14.	Kreu IV/2, pika 12	12.09.2019
15.	Kreu IV/2, pika 13	19.09.2019
16.	Kreu IV/2, pika 14	07.10.2019
17.	Kreu IV/2, pika 15	15.11.2019
18.	Kreu IV/3, pika 1	20.08.2019 - 30.08.2019
19.	Kreu IV/3, pika 6	03.09.2019
20.	Kreu IV/3, pika 8	12.09.2019
21.	Kreu IV/3, pika 9	19.09.2019
22.	Kreu IV/3, pika 10	19.09.2019
23.	Kreu IV/3, pika 11	07.10.2019
24.	Kreu IV/3, pika 13, shkronja “b”	24.01.2020
25.	Kreu IV/3, pika 13, shkronja “f”	15.11.2019
26.	Kreu IV/4, pika 1	11.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike)



		18.10.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
27.	Kreu IV/4, pika 2	22.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 29.10.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
28.	Kreu IV/4, pika 4	30.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 15.11.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
29.	Kreu IV/4, pika 5	01.11.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 08.11.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
30.	Kreu IV/4, pika 8, shkronja “b”	Dhjetor 2019
31.	Kreu IV/4, pika 16	16.12.2019
32.	Kreu IV/5, pika 1	06.09.2019 - 19.09.2019
33.	Kreu IV/5, pika 18	20.09.2019
34.	Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 1	30.09.2019
35.	Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 2	01.10.2019
36.	Kreu IV/5, pika 21	10.10.2019
37.	Kreu IV/5, pika 22, fjalë 1	10.10.2019 - 14.10.2019
38.	Kreu IV/5, pika 22, fjalë 2	18.10.2019
39.	Kreu IV/5, pika 23	16.12.2019
40.	Kreu IV/6, pika 1	11.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 18.10.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
41.	Kreu IV/6, pika 2	22.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 29.10.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
42.	Kreu IV/6, pika 4	30.10.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 06.11.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
43.	Kreu IV/6, pika 5	01.11.2019 (E vlefshme për IAL-të publike) 08.11.2019 (E vlefshme për IAL-të jopublike)
44.	Kreu IV/6, pika 8, shkronja “b”	Dhjetor 2019
45.	Kreu IV/6, pika 16	16.12.2019

**UDHËZIM****Nr. 556, datë 29.7.2019****PËR MËNYRËN E VENDOSJES NË
INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT
SHOQËROR PËR FËMIJËN NDAJ TË
CILIT ËSHTË MARRË MASË
MBROJTJEJE**

Në mbështetje të pikës 5, të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,

UDHËZOJ:**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të garantojë sistemimin e fëmijës në institucionet e përkujdesit shoqëror me efektivitet dhe në përputhje me nevojat e interesin më të lartë, ndaj të cilit është marrë një masë mbrojtjeje sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

2. Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave për vendosjen në institucionet e përkujdesit shoqëror, të fëmijës ndaj të cilit është marrë një masë emergjente mbrojtjeje ose një masë mbrojtjeje për vendosje në përkujdesje alternative.

**KREU II
MËNYRA E VENDOSJES NË
INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT
SHOQËROR PËR FËMIJËN NDAJ TË CILIT
ËSHTË MARRË MASA EMERGJENTE E
MBROJTJES**

1. Fëmija i ndodhur në situatat e parashikuara në pikat a, b dhe c, të nenit 56, të ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, merret menjëherë në mbrojtje. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës (më poshtë në tekst PMF) merr menjëherë masa për të garantuar sigurinë fizike të fëmijës.

2. Në rastet e rrezikut të menjëhershëm dhe rrezikut të lartë, PMF merr masa për vendosjen e fëmijës në shërbimin e emergjencës më të përshtatshëm për fëmijën ose në strehën e përkujdesit shoqëror të përkohshme më të afërt.

3. PMF-ja plotëson formularin e referimit dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas përcaktimeve të bëra në aneksin 10, të vendimit nr. 578, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, në bashkëpunim me punonjësin e policisë në vendodhjen ku identifikohet fëmija. PMF-ja ia dorëzon një kopje të formularit punonjësit social ose personit përgjegjës pranë shërbimit të emergjencës.

4. Punonjësi social pranë shërbimit të emergjencës merr masa për hapjen e dosjes së fëmijës dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme. PMF-ja i dërgon punonjësit social ose personit përgjegjës pranë shërbimit të emergjencës vendimin e drejtorit të strukturës së posaçme të shërbimeve shoqërore në Bashki për masën emergjente të mbrojtjes, i cili merret brenda 24 orëve dhe bëhet pjesë e dosjes së fëmijës.

5. Në rastin kur në Bashkinë ku është identifikuar fëmija, nuk ka shërbime të ngritura emergjente, dosja plotësohet nga PMF-ja që ka ndjekur rastin, në bashkëpunim me punonjësin social të shërbimit emergjent ose strehës së përkohshme, të bashkisë më të afërt, ku do të vendoset fëmija.

6. Pas vlerësimit të plotë të rastit dhe hartimit të Planit Individual të Mbrojtjes, nga Grupi Teknik Ndërsektorial dhe kur vlerësohet së fëmija do të vendoset në një institucion të përkujdestit shoqëror, i ndryshëm nga shërbimi i strehimit emergjent, vendosja në institucion bazohet, për aq sa është e mundur, në:

a) sistemimin e fëmijës në një institucion të përshtatshëm për moshën dhe nevojat e tij;

b) sistemimin e fëmijës në institucionin më të afërt me vendbanimin apo vendqendrimin e tij kur ai është në vazhdim të procesit arsimor dhe/ose ndryshimi i institucionit arsimor do të ndikonte negativisht procesin e të nxënit;

c) sistemimin e fëmijës në institucionin publik ose jo publik rezidencial për fëmijë, më të afërt me vendbanimin apo vendqendrimin e tij, kur ai është veçanërisht i shoqërizuar apo atashuar në aktivitete shoqërore apo me mjedisin familjar, largimi nga të cilët do të ndikonte negativisht në mirëqenien e tij;

d) sistemimin e fëmijës në institucionin më të afërt me shërbimet mjekësore që merr fëmija në



rastet kur ai ka nevojë për kujdes të vazhduar mjekësor pranë një shërbimi të specializuar;

e) sistemimin e fëmijës me nevoja të veçanta në një institucion specifik të specializuar kur kjo vlerësohet si masa më e përshtatshme në interesin më të lartë të tij.

7. Përzgjedhja e institucionit më të përshtatshëm dhe më të afërt, bëhet gjatë mbledhjes së Grupit Teknik Ndërsektorial, në çdo rast në konsultim me njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit pranë bashkisë ose shërbimit social shtetëror rajonal, të cilët japin të paktën tri alternativa për sistemimin e fëmijës, bazuar në nevojat specifike të rastit.

8. Vendimi i Grupi Teknik Ndërsektorial për vendosjen e fëmijës në një institucion specifik, dokumentohet në një procesverbal dhe arsyetohet bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

9. Brenda një periudhe 10-ditore nga vendosja në shërbimin e emergjencës, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në bashkëpunim me njësinë e vlerësimit dhe referimit të rasteve pranë njësisë administrative të Bashkisë, përgatisin dosjen personale të pranimi të fëmijës në institucion, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas parashikimeve të vendimit nr. 518, të Këshillit të Ministrave datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror, komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

Për të trajtuar fëmijën në situatën e emergjencës, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës në njësinë administrative ose në Bashki, ndihmohet dhe asistohet nga punonjësi social i njësisë së qeverisjes vendore, sipas parashikimeve në nenin 19, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

KREU III

MËNYRA E VENDOSJES NË INSTITUCIONET E PÛRKUJDESIT SHOQËROR PÛR FËMIJËN NDAJ TË CILIT ËSHTË MARRË MASA E MBROJTJES PÛR VENDOSJEN E FËMIJËS NË PÛRKUJDESJE ALTERNATIVE

1. Vendosja e fëmijës, me masë mbrojtje, ndaj të cilit është marrë vendimi për t’u vendosur në përkujdesje alternative, vendoset në një institucion rezidencial të përkujdesjes kur është e pamundur që

fëmija të sistemohet pranë një të afërmi apo familjeje kujdestare.

2. Grupi Teknik Ndërsektorial, parashtrohet, të paktën, tri alternativa për sistemimin e fëmijës bazuar, në interesin më të lartë të tij dhe në nevojat specifike të rastit, para marrjes së vendimit final dhe më pas dërgimit të rastit për shqyrtim në gjykatë, me emrin e institucionit të përzgjedhur gjatë mbledhjes.

3. Për vendosjen e fëmijës në një institucion të përkujdesit, në rastet kur fëmija është abuzuar nga prindi ose prindërit apo kujdestari, atëherë duhet të vlerësohet mundësia për ta vendosur fëmijën sa më larg abuzuesve apo mjedisit abuzues.

4. Në këto raste fëmijët duhet të trajtohen si viktimat të dhunës në familje dhe të ndiqen procedurat në bashkëpunim me mekanizmin e koordinuar të referimit në nivel vendor të dhunës në familje, apo me mekanizmin e referimit për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit.

5. Plani individual që ka propozuar masën e mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në një institucion të përkujdesit shoqëror duhet të shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar sipas afatit dhe parashikimeve të vendimit nr. 518, datë 4.9.2018 të Këshillit të Ministrave “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar, rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

KREU IV

VEPRIMET E PUNONJËSIT PÛR MBROJTJEN E FËMIJËS PAS SISTEMIMIT TË FËMIJËS NË NJË INSTITUCION TË PÛRKUJDESIT SHOQËROR

1. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, me qëllim mbikëqyrjen, mbarëvajtjen dhe progresin e fëmijës për të cilën është marrë masë mbrojtjeje realizon kur është e mundur dhe/ose e nevojshme sipas përcaktimeve në Planin Individual të Mbrojtjes:

a) takime me fëmijën e vendosur në institucion për të trajtuar dhe vlerësuar gjendjen psiko-sociale të tij;

b) takime me fëmijën e prindërve, familjarëve, të afërmeve apo shokëve e shoqeve, për të ruajtur marrëdhënie personale me tyre, kur kjo nuk është e dëmshme për fëmijën;



c) përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për gjykatën në procesin gjyqësor të konfirmimit apo jo të masës së mbrojtjes dhe të vendosjes së fëmijës në kujdestari;

d) monitorimin e fëmijës pas daljes nga institucioni për një periudhë deri një vit, sipas standardeve të shërbimeve për fëmijë;

e) vlerësimin e kushteve social – ekonomike të familjes, sipas kërkesave nga institucioni i përkujdesit shoqëror ku ndodhet fëmija, për planifikimin e rikthimit të fëmijës në familje.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, si dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 435, datë 25.7.2019

PËR MASAT E MËTEJSHME URGJENTE NË VITET 2019–2021, PËR REZERVAT E PELAGJIKËVE TË VEGJËL NË DETIN ADRIATIK (NËNZONA GJEOGRAFIKE 17 DHE 18) [REKOMANDIMI GFCM/42/2018/8]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të neneve 13, 14, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, të germave “a” dhe “b” të pikës 1, të nenit 3 të “Marrëveshjes për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun” të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003, të pikave 4 dhe 5, të kreut I të VKM nr. 402, datë 8.5.2013 “Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”, të rregullores nr. 1, datë 7.3.2014 “Për peshkimin”,

URDHËROJ:

1. Zbatimin e Rekomandimi GFCM/42/2018/8 “Për masat e mëtejshme urgjente në vitet 2019–2021 për rezervat e pelagjikëve të vegjël në detin Adriatik (nënzona gjeografike 17 dhe 18)”, që i bashkëngjitet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet sektori i Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e pikave 4–9, 11, 13–15, të rekomandimit.

3. Ngarkohet inspektorati i peshkimit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e pikave 21–23 të Rekomandimit.

4. Kapitenet e anijeve të peshkimit zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga pikat 8–11 të Rekomandimit.

5. Anijet e peshkimit që peshkojnë pelagjikë të vegjël (sardele dhe açuge) nuk duhet të kalojnë 180 ditë peshkimi në vit, me maksimumin 144 ditë peshkimi për sardelen dhe me maksimumin 144 ditë peshkimi për açugen.

6. Anijet e peshkimit që peshkojnë pelagjikë të vegjël (sardele dhe açuge) për vitin 2020–2021 të zbatojnë ndalimin në peshkim, për një periudhë 30 ditore si më poshtë:

- për sardelen 15 shkurt – 15 mars;
- për açugen 1 qershor – 30 qershor.

7. Ndalohet peshkimi i pelagjikëve të vegjël për anijet mbi 12 m gjatësi të përgjithshme, deri në largësinë 6 milje detare nga bregu për periudhën:

- deri më 31 dhjetor 2019;
- 1 maj – 31 dhjetor 2020;
- 1 prill – 31 dhjetor 2021.

8. Peshkimi i pelagjikëve të vegjël do të kryhet me mjetet lundruese që përdorin formën e peshkimit me koshilok (me rrethim) dhe formën e peshkimit me trata pelagjike sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 719, datë 12.10.2016 “Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrat të anijeve të peshkimit”.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

**URDHËR****Nr. 442, datë 29.7.2019****PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
MENAXHIMIT TË PESHKIMIT,
LIQENI ULËZ-SHKOPET 2019–2029**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, neni 55, pika 2, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të peshkimit për liqenin e Ulzës dhe Shkopetit, për periudhën 2019–2029.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, liqeni Ulzë dhe Shkopet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi**

VENDIM*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 913 (13-2019-3857), datë 19.6.2019, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Kujtim Belegu, më datë 7.8.1997.

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në udhëzimin nr. 499, datë 2.7.2019 “Për procedurat e pranimit dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”, botuar në Fletore Zyrtare nr. 109, datë 26.7.2019, në pikat 2 dhe 3, të kreut V “plotësimi i vendeve vakante nëpërmjet programit të bonusit”, bëhet korrigjimi i gabimit material si vijon:

Ishte:

“2. Kandidatët që aplikojnë në Programin e Bonusit duhet të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore publike.

3. Për aplikim nevojitet:

- a) kërkesa për shprehje interesi;
- b) vërtetimi i punësimit nga institucioni shëndetësor ku punon, si dhe leje nga institucioni për pjesëmarrje në Programin e Bonusit;
- c) diploma e specialitetit.”

Bëhet:

“2. Kandidatët që aplikojnë në Programin e Bonusit kur janë të punësuar në institucionet shëndetësore publike, duhet të marrin leje nga institucioni ku punojnë për pjesëmarrje në Programin e Bonusit.

3. Kandidatët që aplikojnë në këtë program, përveç dokumenteve sipas pikës 6, të kreu I, duhet të dorëzojnë dhe vërtetim nga njësia administrative për vendbanimin;”

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë